



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit,

**th ë r r e t**

mbledhjen e **gjashtë** të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **25.07.2022** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. "UÇK", nr. 2.  
Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. Propozimvendimi për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të bllokut urban "D2" në kuadër të planit rregullues 'Arbëria 3' të miratuar me vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01nr.35-94056, të dt. 04.05.2015;
2. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2022 (TM2);
3. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Valbone (Shaip) Mërkoja, Naser (Shaip) Mërkoja, Fatmir (Shaip) Mërkoja dhe Ragip (Shefki) Selimi;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Jeton (Ramiz) Hyseni, Faton (Ramiz) Hyseni dhe Driton (Ramiz) Hyseni;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shaban (Idriz) Hoxha;
7. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me projektregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve me asistencë elektrike të mikromobilitetit në Komunën e Prishtinës;

8. Propozimvendimi për aneks Planin e veprimit për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës;
9. Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal;
10. Propozimvendimi për hapjen e kodit buxhetor;
11. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Prishtina International Film Festival;
12. Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve, Kompania rajonale e mbeturinave "Pastrimi", SHA, Prishtinë;
13. Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Termokos", SHA, Prishtinë;
14. Pyetje dhe përgjigje;
15. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-060/01-156787/22, më 05.07.2022

KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kupina

